

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja individuale Suzana Çerkini me sekretaren juridike Albulena Ademi, në çështjen penale kundër të pandehurit P.Gj. nga P., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.421/2015 të datës 21.09.2017, pas seancës fillestare, të hapur për publikun të mbajtur më datë 22.05.2018 në praninë e Prokurorit të shtetit Fitore Sadikaj, të pandehurit P.Gj. me mbrojtësin me autorizim av.H.M, të njëjtën ditë, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri P.Gj., nga i ati N. dhe nëna Z., e vajzërisë S., i lindur me ... në fshatin K. e V.; komuna K., tani jeton në P., me vendbanim në rrugën “H.K.P.”nr..., ka të kryer shkollën e mesme, student, i papunë, i pamartuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, nga data e papërcaktuar e deri më datë 23.04.2015 rreth orës 01:32, pa autorizim ka poseduar armë, ashtu që gjate nje kontrolli rutinor nga ana e policisë, në rrugën “I.B.” te rrethi afër F. ne P., eshte ndaluar nje veture e tipit “Audi”, me ngjyre hiri, me targa ..., te cilin e drejtonte i pandehuri dhe, gjate kontrollit ne dollapin e veturës i eshte gjetur nje revole e tipit “CZ 99” me numër serik. 5952, nje karikator dhe 15 fishekë te kalibrit 9 mm, ku te gjitha janë sekuestruara nga ana e policisë,

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,42, 46, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe neneve 248, 365 dhe 366 të KPP i shqipton,

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **400€ (katërqind euro)**, të cilin dënim obligohet t'a paguajë brenda brenda 3 kësteve, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet komfor nenit 46 të KPRK, gjykata këtë dënim me gjobë do t'ia shëndrrojë në dënim me burg duke llogaritur 20 euro për një ditë burgim.

I pandehuri është i obliguar që gjobën e lartshënuar t'a paguajë në tre këste, ashtu që këstin e parë do t'a paguajë pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, këstin e dytë në afatin prej 30 ditëve pas pagesës së kështit të parë dhe, këstin e tretë në afatin prej 30 ditëve pas pagesës së kështit të dytë,

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohet: një revole CZ 99 me numër serik.5952, një karikator, dhe 15 fishekë te kalibrit 9 mm, ne baze te vërtetimit mbi marrjen e përkohshme te gjëseneve me nr.2015-AD-1240, te datës 21.04.2015,

I pandehuri obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumë prej **50 € (pesëdhjetë) euro**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.I.nr.421/2015 të datës 21.09.2017, ka akuzuar P.Gj., për veprën penale Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti seancë të shqyrtimit fillestar në të cilin i pandehuri P.Gj. në prani të mbrojtësit të angazhuar me autorizim av. H.M., duke qenë në dijeni të plotë për natyrën, përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajësisë,

pas konsultimit të mjaftueshëm me të njëjtin vullnetarisht pranoi në tërësi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë, duke theksuar se kjo ka qenë hera e parë që ka kryer veprën penale dhe që ka mbajtur armë dhe premtion se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën të tillë penale apo të ngjashme. Gjithashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit av. H.M. e ka mbështetur të pandehurin duke theksuar se i mbrojturi i tij me vetëdije dhe me vullnet të plotë ka pranuar fajësinë pasi që është bindur për benefitet ligjore të pranimit të fajësisë dhe, meqë kjo është hera e parë që i njëjti ka ra në kundërshtim me ligjin dhe nuk është i njohur për organet e ndjekjes, andaj lut gjykatën për një dënim të kuhtëzuar apo dënim me gjobë me mundësi pagese në tri kiste.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri meqë pranimi është në përputhje të plotë me provat nga shkresat e lëndës, andaj mbi këtë bazë i propozoi gjykatës që të nxjerr aktvendim me të cilën do ta aprovojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe pas pajtimit të prokurorit të shtetit, gjykata gjithashtu aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, duke vlerësuar se pranimi është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 248 par.1 të KPP, se i njëjti në mënyrë bindëse dhe të vullnetshme ka pranuar fajësinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike.

Gjykata, pas aprovimit të pranimit të fajësisë së të pandehurit dhe pas vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, andaj pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, dhe i shqiptoi dënim të paraparë ligjor.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit si, rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese, pendimin për veprën e kryer, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit i shqiptoi dënim me burgim, të cilin dënim ia kushtëzoi për periudhën e caktuar verifikuese, siç është e precizuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të pandehurit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale të kësaj natyre dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund, me bindje se i pandehuri në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për konfiskimin e sendeve, gjykata e mori në bazë të nenit 69 lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.292/17, me datë 22.05.2018**

**Zyrtare ligjore
Albulena Ademi**

**Kryetare e trupit gjykues-gjyqtare
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.